



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

BORDI

VENDIM

Nr. 127, datë 13.08.2019

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K., ME NR. 246, SERIA FK14, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 102, DATË 21.12.2009, RINOVUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR. 84, DATË 16.09.2014.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1 gërma “d”, nenit 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.08.2019, mbasi shqyrtoi relacionet e Drejtorisë së Licensimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr. 67/15 Prot., datë 16.07.2019; nr. 67/15-1 Prot., datë 31.07.2019 dhe nr.78/1 Prot., datë 08.08.2019 lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k, me nr. 246, Seria FK14, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE nr. 84, datë 16.09.2014

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 119, datë 22.07.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës me nr. 246, Seria FK14, të shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Shoqëria “GSA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 246, Seria FK14 të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 21.12.2009, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr. 102 datë 21.12.2009 dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 84, datë 16.09.2014.
- Me shkresën nr. 32/33, datë 23.07.2019, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GSA” sh.p.k.

- Në vijim të pyetjeve të ngritura nga bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 22.07.2019, në të cilën u relatua Relacioni me nr. 67/15, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.”, në datën 31.07.2019, u hartua Relacioni Plotësues nr. 67/15-1 Prot.
- Në këtë relacion plotësues u sqaruan pyetjet e ngritura në lidhje me datën e regjistrimit të shoqërisë që është ajo e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë, si dhe afati i vlefshmërisë së licencës që do të rinovohet, i cili fillon nga data 22.12.2019, duke qënë se licenca ekzistuese ka vlefshmëri deri në datën 21.12.2019.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, rezulton si më poshtë:
 - **Neni 16, pika 1, gërma “a”**- Formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gërma “a”; “b” dhe “c” **janë plotësuar.**
 - **Neni 16, pika 1, gërma “b”**- Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gërmat “a”/“b” gërma “c”; gërma “d”; gërma “e” janë plotësuar.
 - **Neni 16, pika 1, gërma “c”**- Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, gërma “a”; gërma “b”; gërma “c” gërma “d” **janë plotësuar.**
 - **Neni 16, pika 1, gërma “d”**- Çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike, **është plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., me nr. 246, Seria FK14, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.20109, rinovuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE nr. 84, datë 16.09.2014 për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 22.12.2019.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI